

PROPOZUES: Qeveria e Republikës së Maqedonisë

PËRFAQËSUES: Bilen Saliji, ministër i drejtësisë
dhe
Oliver Ristovski, zëvendës ministër i drejtësisë

I DELEGUAR: Valentina Shaurek, këshilltare shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë

PROPOZIM – LIGJ
për përdorimin e gjuhëve

Shkup, gusht, viti 2017

HYRJE

I. VLERËSIM I GJENDJEVE NË FUSHËN QË DUHET TË RREGULLOHET ME LIGJIN DHE ARSYET PËR MIRATIMIN E TIJ

Në marrëveshjen kornizë të nënshkruar në vitin 13.08.2001 në Shkup, në pikën 6 Arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve me pikat nga 6.4, 6.5, 6.6, 6.7 dhe 6.8 definohet korniza për përdorim të gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% e popullatës, dhe është ndryshe nga gjuha maqedonase, pika të cilat janë bërë tekst I Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, me Amendamentin kushtetues V I cili e zëvendësoi nenin 7 nga Kushtetuta.

Me paragrafin 1 të Amendamentit V parashihet që në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhënies e saja ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti I saj cirilik, përderisa në neni 2 thotë se gjuhë tjetër që e flasin më së paku 20% e qytetarëve, është gjithashtu gjuhë zyrtare dhe alfabeti I saj, si; parashihet në këtë nen.

Sipas nenit 3 dokumentet personal të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase, jepen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj si dhe në atë gjuhë dhe shkrim në pajtim me ligjin.

Në nenin 4 definohet se, cilido qytetarë që jeton në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund të përdorin cilindo nga gjuhët zyrtare dhe shkrimet e tyre. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetëqeverisjes lokale përgjigjen në gjuhë maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin që e përdor qytetari. Secili qytetar në komunikim me ministrinë mund të përdorë një nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj, ndërsa ministrinë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin që e përdor qytetari.

Në paragrafin e pestë parashihet se në organet e pushtetit qendror në Republikën e Maqedonisë, gjuhë zyrtare, ndryshe nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në pajtim me ligjin.

Me paragrafin e fundit parashihet se në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuha dhe shkrimi që e përdorin më së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare përkrah gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe shkrimeve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e vetëqeverisjes lokale.

Përdorimi i gjuhëve rregullohet në mënyrë më të detajuar me ligjin e përdorimit të gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 101/2008 dhe 100/2011). Ligji në mënyrë të përafërt e definon përdorimin në më shumë fusha: në Kuvend (neni 3), komunikim të qytetarëve me ministrinë (neni 4), procedura gjyqësore (neni 5 - 14), në organet e pushtetit gjyqësor (neni 15 - 17), procedura administrative (neni 18), ekzekutimi i sanksioneve (neni 19), tek institucioni avokati i popullit (neni 20), në procesin zgjedhor dhe në format e deklarimit direkt (neni 21 - 29), dokumentet personale (neni 29, 30), evidenca amë (neni 31), autorizimet policore (neni 32), veprimtaria radiodifuzive (neni 33 - 38), objekte infrastrukturore (neni 40 - 43), gjatë aktiviteteve financiare dhe ekonomike (neni 44 - 47), në arsim dhe shkencë (neni 48 - 53), kulturë (neni 54 - 56),

në procesin e qasjes së lirë deri tek informatat me karakter publik (neni 57) dhe gjatë publikimit të akteve (neni 58).

Në praktikën e deritanishme dhe parregullsitë e vërejtura gjatë zbatimit dhe përfshirja e rregullativës juridike aktuale, është konstatuar nevoja e rregullimit të mëtutjeshëm të materies juridike me të cilën rregullohet përdorimi i gjuhëve, me ç' rast qeveria e Republikës së Maqedonisë propozon ligj të ri për përdorimin e gjuhëve.

Implementimi i Marrëveshjes kornizë është ngushtë i lidhur me procesin euro integruar të vendit, për çka flasin edhe konkluzionet e Këshillit të Evropës viteve të fundit, të cilët tregojnë për nevojën e implementimit të plotë të tij si gurë themel për ndërtimin e mëtutjeshëm të shoqërisë demokratike me karakter multi-etnik si kornizë për sigurimin e së ardhmes së demokracisë në Maqedoni dhe mundësimin e zhvillimit të marrëdhënieve më të afërta dhe më të integruara në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Euro-atlantike.

Në seancën e 16-të të qeverisë të mbajtur më 25.07.2017 është miratuar programi nacional për miratim të së drejtës së UE-së 2017-2019, me të cilën parashihen të gjitha masat që i planifikon qeveria për realizim në këtë vit dhe dy vitet e ardhshme, në kuadër të si cilave parashihe t edhe miratimi i ligjit për përdorim të gjuhëve me çka në mënyrë adekuate është gjeneruar edhe numër EPP 2017.0000.7414, që rregullohet me nenin 76 paragrafi 1 nga rregullorja për punën e Republikës së Maqedonisë sipas të cilit të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë më aderimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, shënohen me flamur të Unionit Evropian dhe numrin e materialit nga programi për miratim të së drejtës së Unionit Evropian (numri EPP).

Duke marrë parasysh që Qeveria vlerëson se bëhet fjalë për propozim-ligj i cili është pjesë e procesit të Euro integritit, propozon që të njëjtin ta procedojë në pajtim me kreun 10-a. Shqyrtimi në seancë të trupit punues të propozim ligjit me kompetencë të trupit punues amë për financim dhe buxhet, propozim ligji me kompetencë të trupit punues amë për çështje ekonomike dhe propozim ligj me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Unionit Evropian, nga rregullorja për punë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

II. Qëllimi, parimet dhe principet kryesore

Qëllimi kryesor i miratimit të ligjit është shndrimi konsekuent i amendamenteve kushtetuese në tekste ligjore në raport me përdorimin dhe zbatimin e gjuhës që e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe shkrimit të saj. Respektivisht, me këtë ligj paralelisht rregullohen parimet, mënyra dhe përgjegjësia e institucioneve për të mundësuar përdorim zyrtar të gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimit të saj *visé a visé* të drejtës së qytetarëve për të përdorur dhe zbatuar atë gjuhë në procedura zyrtare. Njëherit rregullohet edhe përdorimi i gjuhëve tjera, të cilat i flasin qytetarët e bashkësive që janë më pak se 20%.

III. Vlerësimi i pasojave financiare nga propozim ligji në buxhet dhe mjetet tjera publike financiare

Propozim ligji do të nxit implikime fiskale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 106 milionë denarë të cilat do të sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018.

- IV. Vlerësim i mjeteve financiare të nevojshme për zbatim të ligjit, mënyra e sigurimit të tyre, të dhëna për atë se a do të krijojë obligime materiale zbatimi i ligjit për subjekte të caktuara

Për zbatimin e propozim ligjit do të jenë të nevojshme mjete shtesë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe do të krijohen obligime materiale për subjekte tjera.

Mjetet e nevojshme për funksionimin e institucioneve të reja që parashihen në nenin 18 dhe nenin 20 nga ky propozim-ligj, lidhur me zbatimin e dispozitave të propozim ligjit, në vitin e parë vlerësohen të jenë 16 milionë denarë. Këto mjete do të sigurohen në buxhetin për vitin 2018.

Në raport me punësimet në institucionet e reja, një pjesë do të realizohet në mënyrë të transferimit nga institucionet tjera shtetërore, para se gjithash nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes kornizë.

Në mënyrë plotësuese do të ketë nevojë të sigurohen 90 milionë denarë në buxhetin për vitin 2018, të cilat do të distribuohen për përdorues të ndryshëm buxhetor, për implementim të dispozitave nga ky propozim ligj.

Ligji për përdorimin e gjuhëve

Neni 1

(1) Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në raportet e saja ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin më së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj (shqip) në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetërorë në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, organizata dhe ente, komisione, persona juridik që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucione tjera, gjuhë zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj është edhe alfabeti dhe gjuha që flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe shkrimi që e përdorin më së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetin që e përdorin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

(1) Qytetarët kanë të drejtë të përdorin cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetet e tyre në pajtim me nenin 1 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera e kanë për obligim që t'iu mundësojnë qytetarëve shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e këtyre gjuhëve zyrtare si dhe alfabeteve të tyre në cilëndo procedurë si dhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë dhe alfabet zyrtarë.

(2) Në pajtim me të drejtën e qytetarëve për ta përdorur cilën do prej gjuhëve zyrtare të nenit 1 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, në procedurat gjyqësore, administrative, përmbaruese, procedurave para hetimore dhe hetimore, procedurave penale dhe procedurave për kundërvajtje, procedurës kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurave për zbatimin e sanksioneve dhe procedurave tjera të parapara me ligje tjera, gjykatat, prokuroritë publike dhe të gjitha organet, subjektet dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga neni (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në këto dhe procedura tjera.

(3) Në institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji të pushtetit shtetërorë në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin më së paku 20% të qytetarëve në R.M. dhe alfabeti i tyre dhe atë në: komunikimin, përdorimin dhe zbatimin në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve që e përbëjnë pushtetin qendrorë (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjykatat, Prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, në procesin zgjedhor, arsimor, shkencor, shëndetësor, kulturor, zbatimin e autorizimeve policore, veprimtarisë radiodifuzive, noteriatit, përmbarimit, objekteve infrastrukturore, evidentimit amë, dokumentet personal, financat, ekonomia si dhe në sferat tjera.

Neni 3

Funksionarët e zgjedhur ose të emëruar të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera selia e të së cilave është në Shkup apo në komunat në të cilat më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin e tyre zyrtarë e përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik të saj si dhe gjuhën që e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj në qoftë se më së paku një nga të zgjedhurit ose të emëruarit që është funksionar flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Neni 4

(1) Në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi cirilik i saj dhe gjuha që e flasin më së paku 20% të qytetarëve në RM dhe shkrimin e saj.

(2) Deputet, funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, e që e flasin 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë në seanca parlamentare dhe seanca të trupave punues flet dhe në gjuhën që e flasin më së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(3) Deputeti i cili flet gjuhë të ndryshme nga ajo maqedonase, dhe të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të RM kur udhëheq seancën në parlament apo seancë në trupa punues, të njëjtat i udhëheq në atë gjuhë.

(4) Funksionari i zgjedhur apo i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën gjuhë e flasin 20% e qytetarëve në RM, materialet në kohë i pranon gjegjësisht dorëzon edhe në gjuhën dhe shkrimin e tij që të shërbejnë në seancat e parlamentit dhe seancat e trupit punues.

(5) Stenogramet nga seancat e parlamentit dhe seancat e trupave punues si dhe materialet dhe dokumentet tjera jepen dhe ruhen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

(6) Të gjithë ligjet dhe aktet e sjella nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë shpallen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

Neni 5

(1) Në punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik si dhe gjuha që e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabeti i saj.

(2) Seancat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë udhëhiqen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(3) Kur me seancat e Qeverisë, komisionet si dhe kolegjiomet gjeneralë udhëheq funksionar i zgjedhur apo i emëruar i cili flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të cilën gjuhë e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, të njëjtat i udhëheq në atë gjuhë dhe shkrim.

(4) Funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, në seanca të Qeverisë, në komisione të Qeverisë dhe në kolegjiome gjeneralë flet në atë gjuhë.

(5) Funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, materialet i pranon në kohë gjegjësisht i dorëzon në kohë në gjuhën dhe alfabetin e tij që të shërbejnë gjatë seancave të Qeverisë, në komisione ose në kolegjiome gjeneralë.

(6) Stenogramet nga seancat e Qeverisë, seancat e komisioneve dhe kolegjiomeve gjeneralë si dhe materialet dhe dokumentet tjera që jepen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

(7) Të gjitha aktet e sjella nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë jepen dhe shpallen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Neni 6

(1) Institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara sipas detyrimit zyrtar të sigurojnë përdorimin, komunikimin dhe procedurat të realizohen në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj në qoftë se personi gjegjësisht pjesëmarrësit flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM.

(2) Të gjitha vendimet dhe aktet tjera si dhe legjitimacionet të cilat dalin nga kompetencat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) i këtij ligji si dhe të gjitha institucionet, janë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20%

e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse personi gjegjësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM.

(3) Person I zgjedhur ose I emëruar I cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM emrin personal në vendimet dhe aktet tjera në korniza të kompetencave të institucioneve të nenit 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji si dhe të gjitha institucionet, e shkruan në gjuhën dhe alfabetin e tij.

(4) Ueb faqet e institucioneve nga neni 1 I këtij ligji dhe përmbajtja e ueb faqeve përkaj gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, detyrimisht shpallen edhe në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Neni 7

(1) Emrat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji si dhe të gjitha institucionet tjera dhe njësitë e tyre rajonale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha shqipe maqedonase si dhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën angleze. Emrat do të kenë madhësinë dhe fontin e njëjtë dhe emri në gjuhën dhe shkrimin maqedonas do të shkruhet i pari.

(2) Në zyrat rajonale të organeve të administratës shtetërore të cilët mbulojnë së paku një njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, emrat e zyrave dhe të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(3) Vulat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) nga ky ligj dhe të gjitha institucionet me seli në Shkup ose në njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(4) Institucionet nga paragrafi 1 I këtij ligji do të mundësojnë dhe kontribuojnë në punë në mënyrë efikase të shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti I saj cirilik dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 8

(1) Monedhat e letrës dhe të farkuara, si dhe pullat postare do të mbajnë simbole të cilat do ta paraqesin trashëgiminë kulturore të qytetarëve të cilët e flasin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

(2) Markat postare, fletëpagesat, raportet fiskale që dalin nga institucionet e nenin 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, banderolat, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj.

(3) Uniformat e policisë; zjarrfikësve; shëndetësisë; në Shkup dhe në komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 9

(1) Në procedurat gjyqësore, administrative, përmbaruese, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, para hetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore si dhe procedurat tjera para gjyqeve, prokurorive publike si dhe të gjitha organeve tjera, trupave dhe institucioneve, aplikohet gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

(2) Të gjitha procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni realizohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse gjykatës, prokuror publik, palë apo pjesëmarrës tjetër i në procedurë është person i cili flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM.

(3) Të gjitha vendimet, letrat dhe aktet tjera të cilat dalin nga procedurat e parapara me paragrafin (1) të këtij neni, sillen dhe jepen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj në qoftë se gjykatës, prokuror publik, pale apo pjesëmarrës tjetër në procedurë është person i cili flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM.

(4) Institucionet e cekura në paragrafin (1) të këtij neni janë të detyruara të mundësojnë përkthim të të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe materialeve si dhe përkthim simultan të prononcimeve, deklaratave dhe seancave në punën apo procedurën të cilat udhëhiqen.

(5) Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe materialeve gjegjësisht mossigurimi i përkthimit simultan përgjatë gjithë procedurës paraqet shkelje thelbësore të procedurës.

(6) Emrat e institucioneve të cekura në paragrafin (1) të këtij neni në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(7) Në institucionet e cekura në paragrafin (1) të këtij neni me seli në rajonet të cilat përfshijnë më shumë gjykata themelore nga të cilat më së paku njëra nga to gjendet në njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën flitet gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, emrat e atyre institucioneve do të shkruhen edhe në gjuhën që e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(8) Kostot që dalin nga përkthimi për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë si dhe kostot për përkthyes gjyqësor që dalin nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, i bartin vetë institucionet e paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 10

(1) Në procedurë para noterit, dokumentet dhe verifikimet materiale mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

(2) Në procedurën para përmbauesit ku pjesëmarrës është person i cili flet gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, urdhëresat, konkluzionet, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet tjera të përmbauesit lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Neni 11

(1) Institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për ekzekutim të sanksioneve si dhe vetë institucionet kompetente për zbatimin e sanksioneve janë të detyruara në komunikim dhe procedurë të zbatojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse personi për të cilin bëhet fjalë e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM.

(2) Institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për ekzekutim të sanksioneve si dhe vetë institucionet kompetente për zbatimin e sanksioneve janë të detyruara t'ua mundësojnë personave të cilët gjenden në këta institucione të drejtohen edhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 12

(1) Evidencat amë në Shkup dhe në komunat ku më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase udhëhiqen edhe në gjuhën zyrtare të cilën e flet qytetari.

(2) Aktvendimet, certifikatat, vërtetimet si dhe aktet tjera lëshohen edhe në gjuhën zyrtare të cilën e flet qytetari

(3) Dokumentet personale dhe dokumentet e udhëtimit të qytetarëve që flasin gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre, në shërbim zyrtar lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre.

Neni 13

(1) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, formulari i letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e flet qytetari.

(2) Qytetarët të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal të cilat shënohen në letërnjoftim shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.

Neni 14

(1) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, formulari I pasaportës dhe fletudhëtimi shtypen edhe në gjuhën dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.

(2) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat të cilat shënohen në fletën e udhëtimit shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

(3) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal të cilat shënohen në pasaportë shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

Neni 15

(1) Në mbledhjet e Komisionit shtetërorë zgjedhorë dhe komisionet komunale zgjedhore në Shkup dhe komunat në të cilat së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase gjatë realizimit të zgjedhjeve në punën dhe procedurat e të gjitha komisioneve, dhe trupave tjerë dhe institucioneve në mënyrë të barabartë, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti I saj cirilik dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 16

(1) Emri I rrugës, sheshit, urës dhe objekteve tjera infrastrukturore në të gjithë njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilat 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase dhe në Shkup shkruhet në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhë të cilat janë gjithëpërfshirëse nga bashkësia ndërkombëtare.

(2) Në vendkalimet kufitare të Republikës së Maqedonisë si dhe aeroportet në rajonet ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, titujt e institucioneve mbishkrimet tjera dhe udhërrëfyesit shkruhen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre.

Neni 17

(1) Të gjithë ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji të cilat dalin në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, dalin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 18

(1) Për të realizuar qëllimet e këtij ligji, promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e njëtrajtshëm të gjuhës zyrtare që e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj, themelohet Agjenci për zbatim të gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm: Agjenci) në cilësi të personit juridik, me kompetencë, standardizim dhe përdorim të njëtrajtshëm të gjuhës që e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së

Maqedonisë dhe alfabetin e saj, me trupa ndihmës për mbështetje të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) nga ky ligj si dhe institucione tjera.

(2) Drejtorin e Agjencisë e zgjedh Qeveria e Republikës së Maqedonisë pas thirrjes publike me mandat prej 4 vjetëve me të drejtë për rizgjedhje.

(3) Në Agjencinë përkrah përkthyesve të autorizuar gjyqësorë, punësohen edhe gjuhëtar dhe filolog të diplomuar në gjuhën shqipe si dhe lektorë të licencuar.

(4) Drejtori e përfaqëson Agjencinë, udhëheq me punën e tij, l kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe sjell program vjetor për punën e Agjencinë. Drejtori dorëzon raport për punën e Agjencisë deri të Qeveria e Republikës së Maqedonisë së paku një herë në vit dhe atë deri më 31 mars të vitit kalendarik, për vitin paraprak.

(5) Mjetet për punën dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 19

Agjencia është kompetente për:

- Mbështetjen e institucioneve në realizimin e qëllimeve të tyre nga ky ligj përfshirë këtu edhe përkthim dhe korrekturë të dokumenteve;
- Korrekturë të të gjitha akteve që publikohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë;
- Promovon dhe ndërmerr masa për avancimin e përdorimit të gjuhës të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- Përgatit raporte për informimin e Qeverisë për realizimin e kompetencave të saja;
- Për nevojat e Qeverisë përgatit materiale profesionale-analitike të kompetencës së saj;
- Mendim profesional ndaj materialeve që janë në funksion të realizimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- Punë të tjera lidhur me realizimin e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 20

(1) Për monitorim të zbatimit të plotë dhe të përpiktë të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës, formohet Inspektorat për përdorim të gjuhëve (në tekstin e mëposhtëm: Inspektorati) në përbërje të Ministrisë së drejtësisë me cilësi të personit juridik.

(2) Parimet, kompetencat, organizimin e inspektimit dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit për përdorim të gjuhëve rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 21

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e dispozitave të gjuhës do të sjellin masa për promovimin e zbatimit të të gjitha gjuhëve dhe për garantimin e mbrojtjes së gjuhëve të komuniteteve tjera që nuk kanë gjuhë amë zyrtare.

Neni 22

(1) Gjopa pre 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit për kundërvajtje do t'ju shqiptohen organeve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) si dhe gjitha institucioneve tjera për mosrespektim të dispozitave të këtij ligji.

(2) Gjopa nga 30% e gjobës së matur do t'i shqiptohet zyrtarit apo personit përgjegjës në organet e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 23

(1) Në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjithë institucionet kompetente janë të obliguar që t'i sjellin aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji.

(2) Në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet nga neni 7 i këtij ligji.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë programe për ngritjen e vetëdijes për zbatimin e këtij ligji.

(4) Në afat prej një viti dispozitat e ligjeve tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

(5) Në rast të mospërputhshmërisë së dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të ndonjë ligji tjetër, organet janë të obliguar t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

(6) Gjatë miratimit së ligjeve të reja, duhet të përputhen me dispozitat e këtij ligji.

Neni 24

Me miratimin e këtij ligji pushon së vlejture Ligji për përdorim të gjuhës që e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/2008 dhe 100/11)

Neni 25

Ky ligj hyn në kufi me ditën e shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

ARSYETIM I PROPOZIM – LIGJIT

I. ARSYETIM I PËRMBAJTJES SË DISPOZITAVE TË PROPOZIM – LIGJIT

Propozim ligji përmban 25 nene.

Me nenin 1 rregullohet se në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në raportet e saja ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin më së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj (shqip) në

pajtim me këtë ligj. Në të gjitha organet e pushtetit shtetërorë në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, organizata dhe ente, komisione, persona juridik që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucione tjera, gjuhë zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj është edhe alfabeti dhe gjuha që flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe shkrimi që e përdorin më së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetin që e përdorin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale.

Në nenin 2 rregullohet se qytetarët kanë të drejtë të përdorin cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetet e tyre në pajtim me nenin 1 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera e kanë për obligim që t'iu mundësojnë qytetarëve shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e këtyre gjuhëve zyrtare si dhe alfabeteve të tyre në cilëndo procedurë si dhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë dhe alfabet zyrtarë. Në pajtim me të drejtën e qytetarëve për ta përdorur cilën do prej gjuhëve zyrtare të nenit 1 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, në procedurat gjyqësore, administrative, përmbauese, procedurave para hetimore dhe hetimore, procedurave penale dhe procedurave për kundërvajtje, procedurës kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurave për zbatimin e sanksioneve dhe procedurave tjera të parapara me ligje tjera, gjykatat, prokuroritë publike dhe të gjitha organet, subjektet dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e cilëndo gjuhë zyrtare nga neni (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në këto dhe procedura tjera. Në institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji të pushtetit shtetërorë në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin më së paku 20% të qytetarëve në R.M. dhe alfabeti i tyre dhe atë në: komunikimin, përdorimin dhe zbatimin në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve që e përbëjnë pushtetin qendrorë (parlamenti i Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjykatat, Prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, në procesin zgjedhor, arsimor, shkencor, shëndetësor, kulturor, zbatimin e autorizimeve policore, veprimtarisë radiodifuzive, noteriatit, përmbaimit, objekteve infrastrukurore, evidentimit amë, dokumentet personal, financat, ekonomia si dhe në sferat tjera.

Neni 3 lidhet me përdorimin e gjuhës nga ana e funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera selia e të së cilave është në Shkup apo në komunat në të cilat më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin e tyre zyrtarë e përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik të saj si dhe gjuhën që e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj në qoftë se më së paku një nga të zgjedhurit ose të emëruarit që është funksionar flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Me nenin 4 rregullohet materia për përdorim të gjuhëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Sipas këtij neni, në punën e parlamentit të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi cirilik i saj dhe gjuha që e flasin më së paku 20% të qytetarëve në RM dhe shkrimin e saj. Në paragrafin (2) parashihet se deputet, funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, e që e flasin 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë në seanca parlamentare dhe seanca të trupave punues flet dhe në gjuhën që e flasin më së paku

20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Me paragrafin (3) rregullohet përdorimi i gjuhës nga ana e deputetit kur kryeson me seancë në kuvend apo seanca të trupave punues. Respektivisht, sipas këtij paragrafi, deputeti i cili flet gjuhë të ndryshme nga ajo maqedonase, dhe të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të RM kur udhëheq seancën në parlament apo seancë në trupa punues, të njëjtat i udhëheq në atë gjuhë. Me paragrafin (4) rregullohet se funksionari i zgjedhur apo i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën gjuhë e flasin 20% e qytetarëve në RM, materialet në kohë i pranon gjegjësisht dorëzon edhe në gjuhën dhe shkrimin e tij që të shërbejnë në seancat e parlamentit dhe seancat e trupit punues. Paragrafi (5) i këtij neni parasheh se stenogramet nga seancat e parlamentit dhe seancat e trupave punues si dhe materialet dhe dokumentet tjera jepen dhe ruhen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj. Paragrafi i fundit i këtij neni ka të bëjë me publikimin e ligjeve dhe akteve tjera. Sipas këtij paragrafi të gjithë ligjet dhe aktet e sjella nga ana e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë shpallen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë

Në neni (5) rregullohet përdorimi i gjuhëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Sipas këtij neni në Qeveri gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik si dhe gjuha që e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabeti i saj. Seancat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë udhëhiqen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Kur me seancat e Qeverisë, komisionet si dhe kolegjiomet gjeneralë udhëheq funksionar i zgjedhur apo i emëruar i cili flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të cilën gjuhë e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, të njëjtat i udhëheq në atë gjuhë dhe shkrim. Funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, në seanca të Qeverisë, në komisione të Qeverisë dhe në kolegjiome gjeneralë flet në atë gjuhë. Funksionar i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, materialet i pranon në kohë gjegjësisht i dorëzon në kohë në gjuhën dhe alfabetin e tij që të shërbejnë gjatë seancave të Qeverisë, në komisione ose në kolegjiome gjeneralë. Stenogramet nga seancat e Qeverisë, seancat e komisioneve dhe kolegjiomeve gjeneralë si dhe materialet dhe dokumentet tjera që jepen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj. Të gjitha aktet e sjella nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë jepen dhe shpallen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Sipas nenit 6 institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara sipas detyrimit zyrtar të sigurojnë përdorimin, komunikimin dhe procedurat të realizohen në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj në qoftë se personi gjegjësisht pjesëmarrësit flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM. Të gjitha vendimet dhe aktet tjera si dhe legjitimacionet të cilat dalin nga kompetencat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) i këtij ligji si dhe të gjitha institucionet, janë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse personi gjegjësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM. Person i zgjedhur ose i emëruar i cili flet gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM emrin personal në vendimet dhe aktet tjera në korniza të kompetencave të institucioneve të nenit 1

paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji si dhe të gjitha institucionet, e shkruan në gjuhën dhe alfabetin e tij. Ueb faqet e institucioneve nga neni 1 I këtij ligji dhe përmbajtja e ueb faqeve përkaj gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, detyrimisht shpallen edhe në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Në nenin 7 të Propozimit është rregulluar materia e gjuhës në shkrimin e emërimeve në institucionet e nenit 1 paragrafi (3) dhe nenit 2 paragrafi (3) I këtij ligji. Respektivisht, sipas këtij neni Emrat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji si dhe të gjitha institucionet tjera dhe njësitë e tyre rajonale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha shqipe maqedonase si dhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën angleze. Emrat do të kenë madhësinë dhe fontin e njëjtë dhe emri në gjuhën dhe shkrimin maqedonas do të shkruhet i pari. Në zyrat rajonale të organeve të administratës shtetërore të cilët mbulojnë së paku një njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, emrat e zyrave dhe të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Vulat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) nga ky ligj dhe të gjitha institucionet me seli në Shkup ose në njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Institucionet nga paragrafi 1 I këtij ligji do të mundësojnë dhe kontribuojnë në punë në mënyrë efikase të shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti I saj cirilik dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Sipas nenit 8 monedhat e letrës dhe të farkuara, si dhe pullat postare do të mbajnë simbole të cilat do ta paraqesin trashëgiminë kulturore të qytetarëve të cilët e flasin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj. Markat postare, fletëpagesat, raportet fiskale që dalin nga institucionet e nenin 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, banderolat, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj. Në paragrafin (3) parashihet se uniformat e policisë; zjarrfikësve; shëndetësisë; në Shkup dhe në komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Sipas nenit 9 në procedurat gjyqësore, administrative, përmbaruese, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, para hetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore si dhe procedurat tjera para gjyqeve, prokurorive publike si dhe të gjitha organeve tjera, trupave dhe institucioneve, aplikohet gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti I saj. Të gjitha procedurat nga paragrafi (1) I këtij neni realizohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse gjykatës, prokuror publik, palë apo pjesëmarrës tjetër I në procedurë është person I cili flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM. Të gjitha vendimet, letrat dhe aktet tjera të cilat dalin nga procedurat e parapara me paragrafin (1) të këtij neni, sillen dhe jepen në gjuhën maqedonase

dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj në qoftë se gjykatës, prokuror publik, pale apo pjesëmarrës tjetër në procedurë është person I cili flet gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM. Institucionet e cekura në paragrafin (1) të këtij neni janë të detyruara të mundësojnë përkthim të të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe materialeve si dhe përkthim simultan të prononcimeve, deklaratave dhe seancave në punën apo procedurën të cilat udhëhiqen. Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe materialeve gjegjësisht mossigurimi i përkthimit simultan përgjatë gjithë procedurës paraqet shkelje thelbësore të procedurës. Emrat e institucioneve të cekura në paragrafin (1) të këtij neni në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Në institucionet e cekura në paragrafin (1) të këtij neni me seli në rajonet të cilat përfshijnë më shumë gjykata themelore nga të cilat më së paku njëra nga to gjendet në njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën flitet gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, emrat e atyre institucioneve do të shkruhen edhe në gjuhën që e flasin më së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Kostot që dalin nga përkthimi për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë si dhe kostot për përkthyes gjyqësor që dalin nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, i bartin vetë institucionet e paragrafit (1) të këtij neni.

Në nenin 10 është rregulluar përdorimi i gjuhëve në procedurat para noterëve dhe pata përmbareseve. Në pajtim me këtë nen, në procedurë para noterit, dokumentet dhe verifikimet materiale mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj. Në procedurën para përmbaresit ku pjesëmarrës është person I cili flet gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në RM, urdhëresat, konkluzionet, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet tjera të përmbaresit lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj.

Në nenin 11 rregullohet materia e përdorimit të gjuhëve në sferën e ekzekutimit të sanksioneve. Respektivisht, institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për ekzekutim të sanksioneve si dhe vetë institucionet kompetente për zbatimin e sanksioneve janë të detyruara në komunikim dhe procedurë të zbatojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM dhe alfabetin e saj nëse personi për të cilin bëhet fjalë e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në RM. Institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për ekzekutim të sanksioneve si dhe vetë institucionet kompetente për zbatimin e sanksioneve janë të detyruara t'ua mundësojnë personave të cilët gjenden në këta institucione të drejtohen edhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Në nenin 12 parashihet se evidencat amë në Shkup dhe në komunat ku më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase udhëhiqen edhe në gjuhën zyrtare të cilën e flet qytetari. Aktvendimet, certifikatat, vërtetimet si dhe aktet tjera lëshohen edhe në gjuhën zyrtare të cilën e flet qytetari Dokumentet personale dhe dokumentet e udhëtimit të qytetarëve që flasin gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre, në shërbim zyrtar lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre.

Sipas nenin 13 Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, formulari I letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e flet qytetari. Qytetarët të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal të cilat shënohen në letërnjoftim shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.

Në nenin 14 rregullohet materia e gjuhës së qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Sipas këtij neni Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, formulari I pasaportës dhe fletudhëtimi shtypen edhe në gjuhën dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat të cilat shënohen në fletën e udhëtimit shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet. Qytetarëve të cilët flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase e cila gjuhë nuk është gjuhë të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal të cilat shënohen në pasaportë shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

Në nenin 15 thuhet se në mbledhjet e Komisionit shtetërorë zgjedhorë dhe komisionet komunale zgjedhore në Shkup dhe komunat në të cilat së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase gjatë realizimit të zgjedhjeve në punën dhe procedurat e të gjitha komisioneve, dhe trupave tjerë dhe institucioneve në mënyrë të barabartë, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti I saj cirilik dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Me nenin 16 rregullohet se emri I rrugës, sheshit, urës dhe objekteve tjera infrastrukturore në të gjithë njësitë e vetëqeverisjes lokale te të cilat 20% e qytetarëve flasin gjuhë ndryshe nga gjuha maqedonase dhe në Shkup shkruhet në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhë të cilat janë gjithëpërfshirëse nga bashkësia ndërkombëtare. Në vendkalimet kufitare të Republikës së Maqedonisë si dhe aeroportet në rajonet ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, titujt e institucioneve mbishkrimet tjera dhe udhërrëfyesit shkruhen në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e tyre.

Me nenin 17 parashihet se të gjithë ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) I këtij ligji të cilat dalin në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, dalin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Në nenin 18 rregullohet se për të realizuar qëllimet e këtij ligji, promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e njëtrajtshëm të gjuhës zyrtare që e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj, themelohet Agjenci për zbatim të gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm: Agjenci) në cilësi të personit juridik, me kompetencë, standardizim dhe përdorim të njëtrajtshëm të gjuhës që e flasin 20% të

qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj, me trupa ndihmës për mbështetje të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) nga ky ligj si dhe institucione tjera. Drejtori e Agjencisë e zgjedh Qeveria e Republikës së Maqedonisë pas thirrjes publike me mandat prej 4 vjetëve me të drejtë për rizgjedhje. Në Agjencinë përkrah përkthyesve të autorizuar gjyqësorë, punësohen edhe gjuhëtar dhe filolog të diplomuar në gjuhën shqipe si dhe lektorë të licencuar. Drejtori e përfaqëson Agjencinë, udhëheq me punën e tij, l kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe sjell program vjetor për punën e Agjencinë. Drejtori dorëzon raport për punën e Agjencisë deri të Qeveria e Republikës së Maqedonisë së paku një herë në vit dhe atë deri më 31 mars të vitit kalendarik, për vitin paraprak. Mjetet për punën dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Në nenin 19 parashihen kompetencat e Agjencisë dhe atë:

- Mbështetjen e institucioneve në realizimin e qëllimeve të tyre nga ky ligj përfshirë këtu edhe përkthim dhe korrekturë të dokumenteve;
- Korrekturë të të gjitha akteve që publikohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë;
- Promovon dhe ndërmerr masa për avancimin e përdorimit të gjuhës të cilën e flasin 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- Përgatit raporte për informimin e Qeverisë për realizimin e kompetencave të saja;
- Për nevojat e Qeverisë përgatit materiale profesionale-analitike të kompetencës së saj;
- Mendim profesional ndaj materialeve që janë në funksion të realizimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- Punë të tjera lidhur me realizimin e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj.

Risi e rëndësishme që inkorporohet në këtë ligj është Inspektorati për përdorim të gjuhëve. Me nenin 20 parashihet se për monitorim të zbatimit të plotë dhe të përpiktë të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës, formohet Inspektorat për përdorim të gjuhëve (në tekstin e mëposhtëm: Inspektorati) në përbërje të Ministrisë së drejtësisë me cilësi të personit juridik. Parimet, kompetencat, organizimin e inspektimit dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit për përdorim të gjuhëve rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 21 rregullon që Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e dispozitave të gjuhës do të sjellin masa për promovimin e zbatimit të të gjitha gjuhëve dhe për garantimin e mbrojtjes së gjuhëve të komuniteteve tjera që nuk kanë gjuhë amë zyrtare.

Në nenin 22 rregullohet përgjegjësia nga kundërvajtjet dhe gjobat adekuate.

Në nenin 23 parashihen afatet për obligimet më shumë subjekteve që duhet të marrin masa për implementimin e ligjit. Respektivisht, parashihet që në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjithë institucionet kompetente janë të obliguar që t'i sjellin aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji. Në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet nga neni 7 i këtij ligji. Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas

hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë programe për ngritjen e vetëdijes për zbatimin e këtij ligji. Në afat prej një viti dispozitat e ligjeve tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji. Në rast të mospërputhshmërisë së dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të ndonjë ligji tjetër, organet janë të obliguar t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji. Gjatë sjelljes së ligjeve të reja, duhet të përputhen me dispozitat e këtij ligji.

Me nenin 24 parashihet që me miratimin e këtij ligji të pushojë së vlejuri Ligji për përdorim të gjuhës që e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/2008 dhe 100/11).

Me nenin 25 rregullohet hyrja në fuqi e këtij ligji.

II. LIDHJA E NDËRSJELLTË E ZGJIDHJEVE NË DISPOZITAT E PROPOZUARA

Zgjidhjet që përmbajnë dispozitat korrespondojnë me dispozitat kushtetuese për përdorim të gjuhëve që janë rezultat nga Marrëveshja e Ohrit.

III. PASOJAT QË DO TË DALIN NGA ZGJIDHJET E OFRUARA

Pasojat që do të dalin nga miratimi i këtij ligji janë cekur në nenin 23. Respektivisht, parashihet që në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjithë institucionet kompetente janë të obliguar që t'i sjellin aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji. Në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet nga neni 7 i këtij ligji. Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë programe për ngritjen e vetëdijes për zbatimin e këtij ligji. Në afat prej një viti dispozitat e ligjeve tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji. Në rast të mospërputhshmërisë së dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të ndonjë ligji tjetër, organet janë të obliguar t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji. Gjatë miratimit të ligjeve të reja, duhet të përputhen me dispozitat e këtij ligji.